



EDUKIMI MJEDISOR



Qershor 2026

Edukimi mjedisor i ndihmon nxënësit të njihen me çështje të rëndësishme dhe jetike si: ujin, ajrin, tokën, natyrën, biodiversitetin. Ai është veprimtaria akademike dhe praktike, që përfshinë studimin sistematik të mjedisit dhe gjithë marrëdhënieve që e shoqërojnë; përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Përgjatë tyre nxënësit përfshihen emocionalisht dhe fizikisht; ata mësojnë për zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave të ndotjes, mbetjeve, energjisë, ekonomisë qarkulluese. Nxënësit përfshihen në mbrojtjen e natyrës dhe njëkohësisht e duan edhe më shumë atë.



"Shikoni thellë në natyrë dhe atëherë do të kuptoni gjithçka më mirë."

Albert Ajnshtajn

Mentorët e tyre, të cilët janë specialistët e edukimit mjedisor në të 12 AdZM-të e vendit mbështesin, përfshijnë dhe ndërmarrin nisma të përbashkëta me nxënësit, për përmirësimin e mjedisve të ndryshme. Në sajë të këtyre veprimtarive ata zhvillojnë shprehi dhe dije mjedisore, që i bëjnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme e të mençur. Përmes edukimit mjedisor nxënësit e niveleve të ndryshme akademike

vetëdije dhe ndërgjegjësim për mjedisin dhe sfidat mjedisore

kuptojnë dhe analizojnë probleme dhe çështje shqetësuese mjedisore

motivohen dhe përfshihen për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar

ndërmarrin nisma dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit

Përmes këtij manuali mujor Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura paraqet aktivitetet e zhvilluara nga 12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura, me nxënësit e shkollave tëndryshme në mbarë vendin dhe atyre që ndodhen pranë ZM-ve apo në zonat rurale, për gjatë muajit qershor 2026.

Aktivitetet janë zhvilluar në kuadër të ditëve mjedisore, promovimit të zonave të mbrojtura, lojërave të ndryshme edukative dhe argëtuese në mjediset e shkollave apo në natyrë, duke synuar gjithë përfshirjen e nxënësve të të dy gjinive, niveleve të ndryshme ekonomike dhe vendndodhjen gjeografike.

Nxënës të
përfshirë

787

30

Shkolla të
përfshira

Specialistë të
angazhuar

20

38

Mësues të
përfshirë

Orë mjedisore
të realizuara

36



4 Qershor 2026 – Krijë shtegun tënd

AdZM Dibër zhvilloi një orë mjedisore me nxënësit e shkollës “Papa Gjon Pali II”, Ulëz, me temë “Krijë shtegun tënd”.

Përmes punës krijuese, nxënësit mësuan hapat kryesorë për krijimin dhe mirëmbajtjen e shtigjeve natyrore, duke kuptuar rëndësinë e planifikimit, sigurisë dhe sinjalizimit.

5 Qershor 2026 – Dita Botërore e Mjedisit

AdZM Dibër zhvilloi një orë mjedisore në natyrë me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Ibrahim Gjorgji”.

Përmes diskutimeve dhe aksionit të pastrimit, nxënësit u ndërgjegjësuam mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe rolin e secilit në ruajtjen e natyrës.

16 Qershor 2026 – Dita Botërore e Breshkave të Detit

Breshkat e detit janë një pasuri e biodiversitetit detar dhe një specie e rëndësishme për ekosistemet tona. AdZM Dibër zhvilloi një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Kurt Cakoni”, Rrethe Baz, ku nxënësit mësuan për habitatin, jetën dhe rëndësinë e mbrojtjes së tyre përmes diskutimeve dhe aktiviteteve krijuese.

“EDUKIMI MJEDISOR”, SHKODËR



biodiversitet trashëgimia natyrore vëzhgim i shpendëve
edukim mjedisor turizëm i qendrueshëm

5 Qershor 2026 – Dita Botërore e Mjedisit

Në kuadër të Ditës Botërore të Mjedisit, specialistët e AdZM Shkodër, në bashkëpunim me Well Point dhe nxënësit e Medresesë "Haxhi Sheh Shamia", zhvilluan një aktivitet sensibilizues në Shirokë, në Rezervatin Natyror të Menaxhuar "Liqeni i Shkodrës". Aktiviteti përfshiu aksionpastrimi, vëzhgim të shpendëve dhe shëtitje me varkë, duke promovuar mbrojtjen e biodiversitetit dhe habitateve natyrore.

11 Qershor 2026 – Dita Botërore e Rrëqebullit të Ballkanit

Specialistët e AdZM Shkodër, në bashkëpunim me PPNEA, Qendrën Kulturore të Fëmijëve Fushë-Arrëz dhe shkollën 9-vjeçare "Pjetër Arbërori", zhvilluan një aktivitet edukativ kushtuar Rrëqebullit të Ballkanit. Përmes aktiviteteve interaktive, nxënësit u njohën me rëndësinë e mbrojtjes së kësaj specije të rrezikuar dhe të biodiversitetit.

12 Qershor 2026 – Panairi Bujqësor dhe edukimi mjedisor

AdZM Shkodër mori pjesë në Panairin Bujqësor të organizuar nga shkolla 9-vjeçare "Prek Gjoni", ku nxënësit prezantuan prodhime bujqësore të kultivuara prej tyre dhe aktivitete artistike. Aktiviteti promovoi lidhjen me tokën dhe natyrën, duke përcjellë mesazhe për kujdesin ndaj mjedisit, rëndësinë e punës dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.



5 Qershor 2026 – Dita Botërore e Mjedisit

Në kuadër të Ditës Botërore të Mjedisit, AdZM Lezhë zhvilloi një orë mjedisore me nxënësit e klasës së IV-të të shkollës 9-vjeçare “Marash Gjoni”. Përmes materialeve informuese, diskutimeve dhe aktiviteteve krijuese, nxënësit u njohën me rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit, biodiversitetit dhe burimeve natyrore.

8 Qershor 2026 – Dita Botërore e Shtigjeve

AdZM Lezhë zhvilloi një orë mjedisore me nxënësit e klasës së VII-të të Shkollës së Bashkuar “Karl Gega”, me fokus rëndësinë e eksplorimit dhe respektimit të natyrës. Përmes aktiviteteve edukative dhe krijuese, nxënësit mësuan mbi sjelljet e përgjegjshme në mjedis, mbrojtjen e biodiversitetit dhe vlerat e shtigjeve natyrore.



ndërgjegjësim bota nënujore ekosisteme
edukim mjedisor krijimtari ditë botërore



5 Qershor 2026 – Dita Botërore e Mjedisit

AdZM Tiranë organizoi një aktivitet mjedisor me nxënësit e shkollës së mesme të bashkuar “Ymer Lala”, Surrel, në PKMD. Nxënësit vizituan Qendrën e Vizitorëve dhe përshkuan shtegune Kalasë, duke u njohur me vlerat natyrore dhe biodiversitetin e parkut. Aktiviteti promovoi eksplorimin e natyrës dhe rëndësinë e mbrojtjes së saj.

6 Qershor 2026 – Bota nënujore

Specialistët e edukimit mjedisor të AdZM Tiranë, zhvilluan një aktivitet me nxënësit e shkollës së mesme të bashkuar “Bahri Nela”, Zall Bastar, kushtuar botës nënujore dhe rëndësisë së mbrojtjes së oqeanëve. Përmes punimeve artistike, nxënësit përcollën mesazhe për ruajtjen e biodiversitetit detar dhe kujdesin ndaj mjedisit.

26 Qershor 2026 – Pikturim mbi gurë, frymëzuar nga natyra

Fëmijët e qendrës Lincoln nën monitorimin e AdZM Tiranë, realizuan një aktivitet krijues duke pikturuar mbi gurë elementë të frymëzuar nga natyra, fauna dhe flora. Aktiviteti ndërthur edukimin mjedisor me krijimtarinë, duke nxitur dashurinë dhe vlerësimin për natyrën.

15 Qershor 2026 – Njohja dhe mbrojtja e breshkave detare

Në kuadër të aktiviteteve të shkollave verore, specialistët e edukimit mjedisor të AKZM-së zhvilluan një aktivitet ndërgjegjëses me nxënësit e shkollave verore të Qendrës Lincoln, kushtuar njohjes dhe mbrojtjes së breshkave detare. Nxënësit mësuuan mbi rëndësinë e këtyre specieve për ekosistemet detare, rolin e tyre në ruajtjen e ekuilibrit natyror dhe sfidat me të cilat përballen. Përmes aktiviteteve krijuese, ata realizuan punime artistike dhe u pajisën me certifikata “Mik i Breshkave Detare” si vlerësim për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre.



18 Qershor 2026 – Bota magjepsëse e fluturave

Gjatë programit veror edukativ në Qendrën Lincoln, specialistët e edukimit mjedisor të AKZM-së vijuan aktivitetet me fëmijët, duke i njohur ata me botën e fluturave, ciklin e jetës dhe rolin e tyre në ruajtjen e biodiversitetit. Përmes lojërave, diskutimeve dhe krijimtarisë, nxënësit krijuandhe zbukuruan figura fluturash, duke e kthyer aktivitetin në një përvojë edukuese dhe argëtuese.

23 Qershor 2026 – Ekosistemet detare dhe kandilat e detit


Në kuadër të shkollës verore në Qendrën Lincoln, nxënësit u përshinën në një orë mjedisorekushtuar botës nënujore. Specialistët e AKZM-së i njohën ata me rëndësinë e ekosistemeve detare dhe rolin e çdo gjallesë në ruajtjen e ekuilibrit natyror. Aktiviteti vijoi me krijimin e kandilave të detit me materiale të thjeshta, duke ndërthurur njohuritë me kreativitetin.

24 Qershor 2026 – Ripërdorimi i materialeve

Nxënësit e kampit veror në Qendrën Lincoln u njohën me rëndësinë e ripërdorimit dhe dhëniessë një jete të dytë objekteve të përditshme. Përmes një aktiviteti praktik të udhëhequr nga specialistët e edukimit mjedisor të AKZM-së, ata transformuan kavanoza qelqi në punime dekorative me elementë natyrorë, duke mësuar se veprimet e vogla kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit.

25 Qershor 2026 – Parku Kombëtar Detar Karaburun-Sazan

Gjatë aktiviteteve verore edukative në Qendrën Lincoln, specialistët e AKZM-së prezantuan me nxënësit pasuritë natyrore të Parkut Kombëtar Detar Karaburun-Sazan, biodiversitetin detar dhe rëndësinë e mbrojtjes së këtij ekosistemi unik. Përmes një aktiviteti krijues, fëmijët ndërtuan miniaturën e parkut duke pasqyruar botën e tij të pasur nënujore.



26 Qershor 2026 – Flora e Zonave të Mbrojtura

Nxënësit e shkollës verore në Qendrën Lincoln u njohën me florën e zonave të mbrojtura dherëndësinë e saj për ruajtjen e biodiversitetit. Aktiviteti vijoi me një punë praktike krijuese, kufëmijët realizuan korniza dekorative me materiale të ricikluara dhe elementë natyrorë.

29 Qershor 2026 – Zogjtë e detit dhe habitatet bregdetare

Specialistët e edukimit mjedisor të AKZM-së zhvilluan me fëmijët e kampit veror një orë mjedisore kushtuar zogjve të detit. Nxënësit mësuuan mbi rëndësinë e tyre për ekosistemet bregdetare dhe rolin e zonave të mbrojtura në ruajtjen e habitateve. Në përfundim, krijuan një pulëbardhë, simbol të bregdetit tonë.

30 Qershor 2026 – Habitatet e zonave të mbrojtura

Në përmbyllje të aktiviteteve të shkollës verore në Qendrën Lincoln, nxënësit u njohën me habitatet kryesore të zonave të mbrojtura në Shqipëri: malet, fushat, detin dhe liqenet. Përmes një aktiviteti krijues, ata ndërtuan modele të habitateve dhe mësuuan mbi florën, faunën, biodiversitetin dhe rëndësinë e mbrojtjes së natyrës.





3 Qershor 2026 – Dita Botërore e Bëçkiletës

Në kuadër të Ditës Botërore të Bëçkiletës, në Shkollën e Mesme të Bashkuar "Isak Alla", Zgost, u zhvillua një aktivitet ndërgjegjëses nga specialistët e AdZM Elbasan me nxënësit për promovimin e bëçkiletës si një mjet transporti i shëndetshëm dhe miqësor me mjedisin. Gjatëaktivitetit, nxënësit realizuan punime dhe vizatime me temë mbrojtjen e mjedisit.

11 Qershor 2026 – Dita Botërore e Rrëqebullit

Rrëqebulli është një nga speciet më të rralla dhe më të rrezikuara të faunës së egër në Shqipëri. Në kuadër të Ditës Botërore të Rrëqebullit, në Shkollën e Mesme të Bashkuar "Dilaver Nezha", Qukës, u zhvillua një orë mjedisore, gjatë së cilës nxënësit u njohën me rëndësinë e mbrojtjes sëkësaj speciej dhe realizuan vizatime me temë rrëqebullin.





10 Qershor 2026 – Vendosja e tabelave drejtuese në Shtegun e Gjenerukës
Specialistët e AdZM Fier, në bashkëpunim me Shoqatën Mjedisore Horizont EU dhe nxënësit e Shkollës 9-vjeçare Gërmenj, realizuan vendosjen e tabelave drejtuese në Shtegun e Gjenerukës në Parkun Kombëtar Divjakë–Karavasta, duke kontribuar në orientimin e vizitorëve dhe promovimin e turizmit të qëndrueshëm.

11 Qershor 2026 – Vizitë edukative në natyrë

Specialistët e AdZM Fier udhëhoqën një vizitë në natyrë me nxënësit e Shkollës Franceze Ndërkombëtare në Tiranë, ku ata u njohën me vlerat natyrore, biodiversitetin dhe faunën e pasur të Parkut Kombëtar Divjakë–Karavasta.

18 Qershor 2026 – Orë mjedisore

Specialistët e AdZM Fier mirëpritën vogëlushët e Kopshtit "Shtëpiza Ime" nga Durrësi në Parkun Kombëtar Divjakë–Karavasta, ku ata u njohën nga afër me faunën e pasur të parkut. Nëpërmjet një aktiviteti edukues dhe argëtues, fëmijët mësuam më shumë për rëndësinë e mbrojtjes së natyrës, biodiversitetit dhe ruajtjes së zonave të mbrojtura.

“EDUKIMI MJEDISOR”, FIER



orë mjedisore edukim ndërgjegjësim
tokë e shëndetshme park kombëtar vizita ne natyre



1 Qershor 2026 – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, specialistët e AdZM Fier mirëpritën nxënësit e Shkollës "3 Dëshmorët", Kavajë, në Parkun Kombëtar Divjakë–Karavasta, ku ata u njohën me vlerat natyrore, biodiversitetin dhe shëtitën në shtigjet e parkut, duke përjetuar nga afër bukurinë dhe pasurinë natyrore të kësaj zone të mbrojtur.

2 Qershor 2026 – Praktikë mësimore në Parkun Kombëtar Divjakë–Karavasta

Në Parkun Kombëtar Divjakë–Karavasta u zhvilluan praktikat mësimore të studentëve tëprogramit Bachelor në Biologji, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universitetit tëTiranës, për lëndët Botanikë Sistematike dhe Biogjeografi, me asistencën e specialistëve të AdZM Fier.

3 Qershor 2026 – Orë mjedisore

Specialistët e AdZM Fier shoqëruan studentët e Fakultetit të Biologjisë, Universiteti i Tiranës, pranë Qendrës së Vizitorëve, ku ata u njohën me vlerat natyrore dhe biodiversitetin e Parkut Kombëtar Divjakë–Karavasta.

5 Qershor 2026 – Dita Botërore e Mjedisit

Në kuadër të Ditës Botërore të Mjedisit, specialistët e AdZM Fier zhvilluan një bashkëbisedim me studentët e Biologjisë të Universitetit të Elbasanit gjatë një ekspedite në Parkun Kombëtar Divjakë–Karavasta, ku u diskutua mbi biodiversitetin, ndryshimet klimatike dhe rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit.



2 Qershor 2026 – Hiking në Parkun Kombëtar Prespa

Në Parkun Kombëtar Prespa u zhvillua një aktivitet hiking me studentët e Universitetit "Fan S. Noli", dega Turizëm. Gjatë ecjes, pjesëmarrësit u njohën me vlerat e biodiversitetit dhe trashëgimisë natyrore të zonës, ndërsa morën pjesë edhe në shenjimin e shtegut sipas standardeve të sinjalistikës, duke promovuar turizmin e qëndrueshëm dhe rëndësinë e mirëmbajtjes së shtigjeve.

3 Qershor 2026 – Ekspeditë për vëzhgimin e breshkave të tokës

Në bashkëpunim me studentët e Universitetit "Fan S. Noli", dega Turizëm, u organizua një ekspeditë në natyrë për evidentimin dhe vëzhgimin e breshkave të tokës në habitatin e tyre natyror. Aktiviteti synoi njohjen me biodiversitetin, rëndësinë e mbrojtjes së specieve të egra dhe ruajtjen e habitateve natyrore.

5 Qershor 2026 – Dita Botërore e Mjedisit

Me rastin e Ditës Botërore të Mjedisit, në shkollën 9-vjeçare "Kozma Basho" në Pogradec u zhvillua një orë mjedisore kushtuar mbrojtjes së natyrës. Përmes diskutimeve dhe aktiviteteve ndërvepruese, nxënësit u njohën me rëndësinë e biodiversitetit, trashëgimisë natyrore dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

5 Qershor 2026 – Dita Botërore e Mjedisit

Në kuadër të Ditës Botërore të Mjedisit, me nxënësit e shkollës "Sevasti Qirjazi" në Korçë u zhvillua një aktivitet edukues me lojëra, kuize dhe ushtrime ndërvepruese. Përmes këtyre aktiviteteve, nxënësit u njohën me rëndësinë e mbrojtjes së biodiversitetit, trashëgimisë natyrore dhe zonave të mbrojtura, duke promovuar edukimin mjedisor që në moshë të hershme.



16 Qershor 2026 – Dita Botërore e Breshkave Detare

Me rastin e Ditës Botërore të Breshkave Detare, specialistët e AdZM Vlorë, në bashkëpunim me shoqatën Flag Pine, zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Elite". Gjatë aktivitetit, nxënësit u njohën me ciklin jetësor të breshkave detare, rëndësinë e ruajtjes së tyre dhe kërcënimet me të cilat përballen, veçanërisht nga ndotja me mbetje plastike. Përmes diskutimeve dhe aktiviteteve krijuese, ata përcollën mesazhe për mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit